



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 232, datë 02.07.2020

PËR
MIRATIMIN E MODELIT TË PROCESVERBALIT “PËR PASQYRIMIN E
VEPRIMEVE QË KRYHEN GJATË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES ME SHORT
TË ÇËSHTJEVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
GJYQTARIT”

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, si dhe në nenet 84 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe Vendimin nr. 197, datë 11.6.2020 “Për miratimin e rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Modeli i procesverbalit miratohet në formatin shkresor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor .

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

MODEL _____, më _____._____

PROCESVERBAL

PËR PASQYRIMIN E VEPRIMEVE QË KRYHEN GJATË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES ME SHORT TË ÇËSHTJEVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT _____ (emri/mbiemri i gjyqtarit)

Sot, më datë _____._____, ora ____:____, në ambientet e Gjykatës _____, mbahet ky procesverbal, për të dokumentuar të gjitha veprimet që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit _____, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.197, datë 11.06.2020 “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit” dhe vendimit të relatorit me datë _____._____.

Në procedurën e përzgjedhjes së çështjeve me short marrin pjesë:

Z/Znj. _____ - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve në KLGJ;

Z/Znj. _____ - Kancelar i Gjykatës;

Z/Znj. _____ - Sekretare Gjyqësore;

Z/Znj. _____ - Punonjës përgjegjës për teknologjinë e informacionit në Gjykatë;

Të pranishëm në procedurën e përzgjedhjes së çështjeve me short :

Z/Znj. _____ - Anëtar/e i K.V.E.V.P;

Z/Znj. _____ - Gjyqtari subjekt vlerësimi;

Z/Znj. _____ - Punonjës përgjegjës për teknologjinë e informacionit në KLGJ;

Ky procesverbal mbahet nga sekretarja gjyqësore Z/Znj. _____.

Bazuar në vendimin e relatorit z/znj _____, të datës _____._____, fillon procedura e shortit për përzgjedhjen e çështjeve, sipas renditjes së mëposhtme:

Hapi 1: Përzgjedhja me short e çështjeve të gjykuara përtej afateve standarde (afat ligjor dhe standard minimal) nëse ka të tilla të përcaktuara në vendimin e relatorit.

Sipas tabelës me të dhëna statistikore për çështjet për të cilat është vendosur përtej afateve standarde, zhvillohet procedura e shortit në përfundim të të cilës, pasi u kryen veprimet verifikuese, u përzgjedhën ___ çështjet si më poshtë:

1. Çështja me nr. regjistri ____, datë regjistrimi ____, nr.vendimi _____, datë vendimi _____;
2. Çështja me nr. regjistri ____, datë regjistrimi ____, nr.vendimi _____, datë vendimi _____;

Në të njëjtën mënyrë përshkruhen të gjitha çështjet e përzgjedhura të kësaj kategorie.

Hapi 2: Përzgjedhja me short e çështjeve për vlerësim të përgjithshëm sipas numrit e kategorive të përcaktuara në vendimin e relatorit.

Sipas tabelës me të dhëna për çështjet civile me palë kundërshtare¹, zhvillohet procedura e shortit në përfundim të të cilës, pasi u kryen veprimet verifikuese, u përzgjedhën ___ çështje si më poshtë:

1. Çështja me nr. regjistri ____, datë regjistrimi ____, nr.vendimi ____, datë vendimi _____;
2. Çështja me nr. regjistri ____, datë regjistrimi ____, nr.vendimi ____, datë vendimi _____;

Në të njëjtën mënyrë përshkruhen të gjitha çështjet e përzgjedhura të kësaj kategorie.

Sipas tabelës me të dhëna për çështjet civile pa palë kundërshtare, zhvillohet procedura e shortit në përfundim të të cilës, pasi u kryen veprimet verifikuese, u përzgjedhën ___ çështje si më poshtë:

1. Çështja me nr. regjistri ____, datë regjistrimi _____, nr.vendimi _____, datë vendimi _____;
2. Çështja me nr. regjistri ____, datë regjistrimi _____, nr.vendimi _____, datë vendimi _____;

Në të njëjtën mënyrë përshkruhen të gjitha çështjet e përzgjedhura të kësaj kategorie.

Në të njëjtën mënyrë, bazuar në vendimin e relatorit, pasqyrohen veprimet e tjera që kryhen gjatë përzgjedhjes me short të të gjitha çështjeve për vlerësim të përgjithshëm, për secilën kategori.

Pas zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së çështjeve me short, pjesëmarrësit parashtrojnë vërejtje për procedurën e zhvillimit të shortit, nëse ka të tilla.

Subjekti që parashtron vërejtjen: _____

Përmbajtja e vërejtjes: _____

Procedura e shortit përfundoi në orën __. __;

Në përfundim procesverbalit lexohet dhe nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit.

Një kopje e procesverbalit i dorëzohet kancelarit të gjykatës dhe një kopje gjyqtarit subjekt vlerësimi. Kopja origjinale administrohet në dosjen e vlerësimit të gjyqtarit.

¹Kategoria e çështjes në këtë procesverbal është për efekt ilustrues pasi ndryshon sipas juridiksionit të gjykatës.

Nëpunësi përgjegjës për vlerësimin _____

Kancelari i Gjykatës _____

Punonjësi përgjegjës IT i Gjykatës _____

Anëtari i KVEVP _____

Gjyqtari subjekt vlerësimi _____

Punonjësi përgjegjës IT i KLGJ _____

Sekretare gjyqësore _____